



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Date: 14/11/2018 Nr.020-1297
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Junikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr.02/30 për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim
I miratuar më datë: 31/10/2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07/11/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim Nr.02/30 për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim	Ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 8, paragrafët 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se, “Paragrafi-1: Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë, formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve. Paragrafi-2: Kryetari i Komunës i propozon tre (3) anëtarë nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës tre (3) anëtar nga subjektet e ndryshme të përfaqësuara në Kuvend, dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Junikut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

U nastavku ćete naći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

Br.	Formulisanje u aktu opštine	Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br.02/30 za osnivanje Komisije za procenu davanja na korišćenje nepokretne imovine opštine	Ova odluka je u suprotnosti sa Zakonom br.04/L-144 o davanju na korišćenje I razmenu nepokretne imovine opštine, članom 8, stavkam 1 i 2, sa kojom se definiše da: "Stav-1: za sprovođenje postupaka za davanje na kratkoročno I dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine, formira se Komisija za procenu za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine koja se sastoji od sedam (7) članova. Stav-2: gradonačelnik opštine predlaže tri (3) člana iz opštinske vlasti, tri (3) člana iz Skupštine opštine predstavljeni od strane različitih političkih subjekata predstavljenih u skupštini, jednog (1) člana iz I jednog stručnjaka iz civilnog društva.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine Junik traži da preduzmaju konkretne mere kako bi opštinski akt uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od trideset (30) dana, od dana prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/30;
Datë: 31.10.2018 .

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Lokalne Samouprave / Administration
Ministry of Local Government Administration
Data: 31.10.2018
Kryetari: [Signature]
-VI- 020-1297

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 8 paragrafi 1. të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Ligji Nr. 04/L-144, GZRK numër 35/17); dhe nenit 22 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.10.2018 nxjerrë:

VENDIM

për

themelimin e Komisionit Vlerësues për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim

I. Me këtë vendim themelohet Komisionit Vlerësues për Dhënie e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim /në tekstin e mëtejme komisioni/.

II. Komisioni nga pika I. e këtij vendimi do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë (neni 8 paragrafi 2. i Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës), 3 (tre) anëtarë propozohen nga ana e ekzekutivit të Komunës së Junikut, 3 (tre) anëtarë propozohen nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe 1 (një) anëtar propozohet nga shoqëria civile.

1. Albert Gjocaj AAK-PDK,
2. Xhemë Tofaj AAK-PDK,
3. _____ LDK-LVV,
4. Arton Krasniqi- nga ekzekutivi,
5. Turim Ganijaj - nga ekzekutivi,
6. Shpejtim Kuqi - nga ekzekutivi,
7. Elbasan Qestaj - nga shoqëria civile.

III. Propozimet nga pika II. e këtij vendimi i procedohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

IV. Mandati i anëtarëve të komisionit nga pika I. e këtij vendimi është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

V. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë:

1. Zgjedhja e kryetarit të komisionit;
2. Hartimi i njoftimit publik me të dhënat për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim;
3. Prezenca në ankand publik (hapjen publike të ofertave);
4. Vlerësimi final i ofertave më të favorshme ekonomikisht për komunën në përputhje me kriteret e përcaktuara me njoftimin për ankand publik dhe shprehje të interesit;
5. Procedimi për shqyrtim dhe miratim i ofertës më të favorshme të përzgjedhur nga ana e komisionit në Komunën e Junikut; dhe
6. Detyra të tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme nga ana e komisionit dhe nuk janë të përcaktuara me këtë vendim.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka cenë e rregulluar.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryetari i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

